



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
MK-81
Prishtinë, më 27 tetor 2009, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 27 TETOR 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, dhe Mufera Sinik, ndërsa munguan: Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci dhe Sllobodan Petroviq.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ardian Gjini dhe Xhezair Murati, kurse munguan: Ibrahim Makolli, Bojan Stojanoviç dhe Lulzim Zeneli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Skënder Reçica dhe Mehmet Hajrizi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Naim Abazi dhe Sherif Konjufca;

Nga: NDI: Avni Zuka dhe

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Xhavit Haliti propozoi që pika 3.11 të hiqet nga rendi i ditës.

Kryesia, pasi diskutoi vendosi që pika 3.11- Kërkesa e Prokurorisë Publike për heqjen e imunitetit të deputetit Agim Veliu, të hiqet nga rendit të ditës, me arsyetimin se kjo çështje nuk është në kompetencë të Kuvendit, sipas nenit 75 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 tetor 2009,
2. Propozimi i rendi të ditës për seancën e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave.

1. Miratimi Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 tetor 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 tetor 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendi te ditës për seancën e ardhshme plenare

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pik, veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, **v e n d o s i** që data për seancën e ardhshme të Kuvendit të caktohet në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë, ndërsa për rend dite i propozoi këto pika:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë Projektligjit për borxhet publike,
4. Shqyrtimi i Raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për vitin 2008, si dhe
Pikat e tjera që përgatiten gjatë javës në vijim, mund të radhiten për seancën e ardhshme.

3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i propozimit të Komisionit për Integritime Evropiane për ta radhitur në rend dite të seancës plenare shqyrtimin e Raportit të Komisionit Evropian për progresin në Kosovë, për vitin 2009 dhe

3.2 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të LDD-së për të debatuar në seancë plenare mbi Raportin e Komisionit Evropian për progresin në Kosovë, për vitin 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit për Integritime Evropiane dhe kërkesën e Grupit Parlamentar të LDD-së, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Raporti i Komisionit Evropian për progresin në Kosovën, për vitin 2009, t'u dërgohet të gjithë deputetëve të Kuvendit.
2. Kërkohet nga Komisioni për Integritime Evropiane që ta shqyrtojë Raportin e Komisionit Evropian për progresin në Kosovën, për vitin 2009 dhe Kuvendit t'ia paraqes rekomandimet para se ai të shqyrtohet në seancë plenare.

3.3 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme lidhur me humbjen e jetës së qytetarëve të Kosovës në lumin Tisa, në kufirin Serbi-Hungari

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Grupit Parlamentar të AAK-së, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme që ta përgatisin një Informatë për rastin e tragjedisë, ku humbën jetën disa qytetarë të Republikës së Kosovës në lumin Tisa në kufirin Serbi-Hungari.
2. Informata e kërkuar sipas paragrafit një (1) të këtij përfundimi t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, para se kjo çështje të diskutohet në seancë plenare.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të AKR-së për të debatuar në seancë plenare lidhur (mos) implementimin e aktvendimeve të formës së prerë për pronësitë e trajtuara si uzurpime arbitrare të tokave të pronësisë shoqërore

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Grupit Parlamentar të AKR-së vendosi që kjo kërkesë të futet në rendin e ditës të seancës plenare të Kuvendit brenda tri javësh pune, nga dita kur është marrë kjo shkallë e mbështetjes, për të cilën çështje vendos Kuvendi.

3.5 Njoftimi me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion e Gjyqësi dhe Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media që para datës 1 dhjetor 2009 ta shqyrtojnë Vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me masën e përkohshme për parapagimin e RTK-së dhe Kuvendit t'ia paraqesin rekomandimet lidhur me të.

3.6 Njoftim lidhur me krijimin e Komisionit ad-hok për emërimin e një anëtari në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës

Kryesia, pasi u njoftua që është shpallur konkursi për një anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Autorizohet Komisioni ad-hoc, i formuar me vendimin të Kuvendit, datë 18 shtator 2008, që të vazhdojë punën për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

3.7 Shqyrtimi i ftesës së Asamblesë Parlamentare të NATO-s për pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit në Seancën vjeshtore, në Edinburg të Skotlandës, më 13-17 nëntor 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Emrat e anëtareve të delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do marrin pjesë në Seancë vjeshtore të Asamblesë së NATO-s, të propozohen nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, pas formimit të tij.

3.8 Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit të delegacionit të Kuvendit në Kroaci, më 26 - 27 tetor 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, moti këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Kuvendit, në përbërje të deputetëve: Xhavit Haliti, Myzejene Selmani, Xhevdet Neziri dhe Naser Osmani, si dhe zyrtarët

e administratës së Kuvendit Natasha Prica-Tišma e Hasan Tahiri, për të marrë pjesë në Seminarin e organizuar nga Parlamenti Evropian në Zagreb, Kroaci, prej 23 - 28 tetor 2009.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi i mbulon Kuvendi, ndërsa rimbursimi bëhet nga Parlamenti Evropian.

3.9 Shqyrtimi i kërkesës për ridestinimin e mjeteve lidhur me realizimin e projekteve investive

Sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, njoftoi në hollësi anëtarët e Kryesisë me propozimet për ridestinimin e mjeteve për realizimin e projekteve investive.

Kryesia, pasi diskutoi për ridestinimin e mjeteve për investime, mori këtë:

V E N D I M

Për ridestinimin e mjeteve për realizimin e projekteve për investime kapitale

1. Për blerjen e dy veturave për Kuvend në shumën prej 11,770 €, mjetet ridestinohe nga Projekti - Rinovimi i rampave.
2. Për blerja e dy kombibusave në shumën prej 24,000 €, mjetet ridestinohe nga Projekti - Blerja e një kombibusi.
3. Për blerjen e 3 veturave në shumën prej 130,000 €, mjetet ridestinohe nga Projekti për blerjen e 13 veturave.
4. Për blerjen e një shtëpizë për sigurimin e ndërtesës në hyrje të garazhit, në shumën prej 5,000€, mjetet ridestinohe nga Projekti - Rinovimi i rampave.
5. Për ndërrimin e Trafostacionit në shumën prej 43,500€ për KEK-un, si dhe për shërbimet e tjera komunale, që nuk kanë qenë parashkuara me Buxhetin e vitit 2009, në shumë prej 11,000 (Shuma e përgjithshme e dy pozicioneve: 54,500€), mjetet ridestinohe nga Projekti vila "Gërmia".

3.10 Njoftimi me kërkesën e donatorëve për ndarjen e zyrave në ndërtesën e Kuvendit

Kryesia shqyrtoi kërkesën e donatorëve për ndarjen e zyrave në ndërtesën e Kuvendit. U konstatua se zyrat mund të ndahen pasi që Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Transportit dhe Postelekomunikacionit të zhvendosen nga objekti i Kuvendit, sipas vendimit të më hershëm të Kryesisë.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI
